

Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në botë

Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut 24-30.03.2025

Janë testuar gjithsej 213 materiale në Laboratorët ku bëhen analiza molekulare për vërtetimin e pranisë së virusit SARS-CoV-2. Krahasuar me javën që shkoi (n=217) është shënuar një rënie prej 1,8%.

Tabela 1. Numri i testeve dhe rasteve pozitive në periudhën nga 24-30.03.2025

Data	Testime	Pozitive	% e rasteve pozitive
24.3.2025	37	0	0,0%
25.3.2025	26	0	0,0%
26.3.2025	44	2	4,5%
27.3.2025	48	0	0,0%
28.3.2025	31	0	0,0%
29.3.2025	10	0	0,0%
30.3.2025	17	0	0,0%
Gjithsej	213	2	0,0%

Gjatë javës së kaluar (24-30.03.2025) nuk janë raportuar raste të vdekjes si pasojë e COVID-19.

GJENDJA ME COVID-19 NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT NË VITIN 2025

Gjatë vitit 2025, deri më 30.03.2025, janë regjistruar gjithsej 31 raste me COVID-19. Në muajin mars të vitit 2025 numri i të sëmurëve (n=4) është për 3 më i vogël se në muajin shkurt 2025 (n=7).

Gjatë vitit 2025, deri më 30.03.2025, janë testuar gjithsej 3.973 materiale, në laboratorët në të cilët realizohen teste molekulare për prani të SARS-CoV-2 dhe në laboratorët / institucionet shëndetësore në të cilat bëhen testimet e shpejta antigjene.

Vlerësimi i rrezikut

Shkalla e ulët e transmetimit të SARS-CoV-2, rënia e numrit të raportimeve dhe testeve ndikon në aftësinë për vlerësimin e gjendjes epidemiologjike. Popullata e EU/EEA në përgjithësi ka një nivel të konsiderueshëm të imunitetit hibrid (vaksinim/vaksinim me booster doza), që ofron një mbrojtje nga format e rënda të sëmundjes. Personat mbi 60 vjet janë më të rrezikuar nga pasqyra e rëndë e sëmundjes.

Hospitalizimi i personave me COVID-19 të konfirmuar, pranimet në kujdesin intensiv dhe vdekjet mbeten në nivel të ulët në vendet e BE-së. Këto të dhëna nuk janë të disponueshme në R. e Maqedonisë së Veriut.

Edhe pse numri i të sëmurëve me COVID-19 në javë po shënon rënie, duke pasur parasysh se fillon periudha e qarkullimit të shtuar të viruseve respiratore në hemisferën veriore, ekziston rreziku që aktiviteti i SARS-CoV-2 të rritet, gjë që e thekson nevojën e vazhdueshme për mbikëqyrje (epidemiologjike dhe virologjike) në nivel kombëtar dhe rajonal.

Masa të rekomanduara për parandalim dhe kontroll

Rekomandohet ndjekja e masave themelore për parandalimin e COVID-19 dhe sëmundjeve të tjera respiratore.

Vaksinimi mbetet si masë specifike që mundëson mbrojtje nga format e rënda të sëmundjes, edhe pse ky efekt mbrojtës me kalimin e kohës dobësohet. Mbetet rekomandimi për vaksinimin e personave me rrezik të lartë nga format e rënda të sëmundjes (siç janë personat më të moshuar).¹

Shkup, 01.04.2025

Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse

Instituti i Shëndetit Publik

¹ <https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/2024-WCP-0039%20Final.pdf>